

Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Komuna Rahovec - Opštine Orahovac

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë - Sektori për pronë
Odeljenje za Katastar, Geodeziju i Imovinu - Sektor za imovinu

Data - Datum	06.03.2020
Referencë/a	08 nr.11/2020
Për/Za/To :	Qenan Fadil Zeqiri nga Krusha e Madhe
Zona Kadastrale:	Krushë e Madhe
Përmes/ Prekp/Through:	Afrim Oruqi - Drejtor
Nga/Od/From/	Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, dhe Pronë
Subjekt/Subekat/Subject:	Spektori për Pronë
	Vendim-për uzurpim

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë - Sektori për pronë K.K. Rahovec duke vendosur sipas kërkesës së Drejtorisë për Punë Inspektuese – Inspektori i Ndërtimtarisë 14 nr. 671/2020 më datë: 18.02.2020, me të cilën është kërkuar që të zhvillohet procedura e uzurpimit arbitrar në pronësinë shtetërore, kundër të dyshuarit Qenan Fadil Zeqiri nga Krusha e Madhe, në bazë të nenit 16, 17 dhe 18 të Ligjit Mbi Shqyrtimin e Marrëdhënieve Pasurore të krijuar me uzurpim arbitrar të tokës në pronësinë shtetërore (“ Gazeta zyrtare e KASK ”, nr. 46/77 dhe 37/88), dhe nenit 21 të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 05/L-031, merr:

V E N D I M

I. VERTETOHET Se Qenan Fadil Zeqiri nga Krusha e Madhe, me ndërtimin e objektit të karakterit ekonomik (autolarje) duke vendosur pllakën prej betoni, shtyllat prej druri dhe mbulojën me material metalik (llamarina), në parcelën komunale nr. 2758-0 Zona Kadastrale Krushë e Madhe, e cila evidentohet në emër të P.Sh. e Kosovës K.K. Rahovec - Ujërat, duke bërë uzurpim arbitrar të pasurisë shtetërore, në sipërfaqe të përgjithshme prej 54 m².

II. Uzurpuesi arbitrar Qenan Fadil Mazreku nga Krusha e Madhe është i obliguar që pjesën e parcelës së uzurpuara ta liroj me mënjanimin e objektit të ndërtuara, të cekura në pikën I të këtij vendimi dhe të njëjtën ta kthej në gjendjen e mëparshme, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendim.

III. Nëse i përmenduri në afatin e caktuar ligjor nuk e liron sipërfaqen e uzurpuar, vendimi do të ekzekutohet në mënyrë të dhunshme.

IV. Uzurpimi është kryer në vitin 2020.

V. Shpenzimet e procedurës bien në barrë të uzurpuesit arbitrar.

A r s y e t i m

Inspektori i ndërtimtarisë me kërkesën 14 Nr. 671-2020 më datë: 18.02.2020 ka njoftuar këtë drejtori se gjatë mbikëqyrjes së rregullt inspektuese mbi ndërtimin e objekteve pa leje në Komunën e Rahovecit përkatësisht në fshatin Krushë e Madhe ka hasur tek Qenan Fadil Zeqiri nga Krusha e Madhe, ndërtimin e objektit të cekura në pikën I në dispozitivin e këtij vendimi, për çka dyshohet se ky ndërtim është bërë në pjesën e parcelën komunale nr. 2758-0 dhe ka kërkuar nga kjo drejtori të vërtetohet gjendja faktike në vendin e ngjarjes.

Drejtorja për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë – Sektori për Pronë i K.K. Rahovec së bashku me gjeodetin e kësaj drejtorie kanë dal në vendin e ngjarjes dhe pas matjes dhe incizimit së parcelës komunale nr. 2758-0, ka konstatuar se i përmenduri me veprimet që ka ndërmarr ka bërë uzurpim arbitrar në parcelën komunale në të cilën eksperti i gjeodezisë ka hartuar skicën e terrenit, me të cilën shihet qartë pozita, kufiri dhe sipërfaqja e uzurpuar.

I përmenduri në deklaratën të cilën e ka dhënë më datë: 02.03.2020, ka cekur se ka aplikuar për leje përkatëse në drejtorin e urbanizmi, dhe se jam në pritje deri sa të zhvillohet procedura për dhënien e lejes, objektin e kam ndërtuar sepse nuk kam kurrfarë të ardhura tjera dhe kam menduar se me këto të ardhura sadopak ta mbaj familjen time. Nëse vërtetohet se kam bërë uzurpim arbitrar, unë do të veproj komfor dispozitave ligjor në fuqi.

Kjo drejtori ka analizuar dhe vlerësuar faktet dhe në fund ka vendosur në këtë çështje administrative, pasi që gjatë matjes dhe incizimit të parcelës në fjalë të pasqyruar në skicën e terrenit, është vërtetuar se i përmenduri, ka bërë uzurpim arbitrar.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, në bazë të nenit 16, 17 dhe 18 të Ligjit mbi shqyrtim e marrëdhënieve pasurore të krijuar me uzurpim të tokës në pronësi shtetërore (“ Gazeta Zyrtare e KASK”, 46/77 dhe 37/88 ”), është vërtetuar se i përmenduri ka bërë uzurpim arbitrar në parcelën komunale, të cekur në dispozitiv të këtij vendimi.

U vendos pranë Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë – Sektori i Pronës K.K. Rahovec, më datë 06.03.2020

08 nr. 11/2020

KESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi mund të parashtrohet ankesë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës - Prishtinë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit përmes kësaj drejtorie.

Hartuesi

Jurist i Diplomuar.




Nazmi Krasniqi



Drejtori

Jurist Diplomuar.



Afrim Oruqi